

PROCESVERBAL
nga seanca e 8-të publike e Këshillit të Agjencisë së Shërbimeve
Mediatike Audio dhe Audiovizuale
të mbajtur me datë 28.07.2026

Anëtarët e Këshillit të Agjencisë të pranishëm nëpërmjet lidhjes video-konferencë: mr. Sasho Stefanovski, mr. Zirjeta Jajaga, Afrona Vërzivolli, Cvetanka Minovska, Petar Xhurovski, Viktor Pavlovski.

Anëtarët në mungesë të Këshillit të Agjencisë: mr. Gordana Majnova (pushim vjetor).

Në seancë nëpërmjet lidhjes video-konferencë ishte i pranishëm dhe dr. Zoran Trajčevski, drejtori i Agjencisë së Shërbimeve Mediatike Audio dhe Audiovizuale.

Të punësuar nga shërbimi profesional të pranishëm nëpërmjet lidhjes video-konferencë: mr. Dragica Ljubevska, dr. Ivana Stojanovska, mr. Emilija Janevska, Cvetanka Mitrevska, Goran Radunović, Magdalena Davidovska-Dovleva, Maja Damevska, Sergej Todorovski.

Të pranishmit e tjerë: /

Kryetari i Këshillit, mr. Sasho Stefanovski, hapi seancën e 8-të publike të Këshillit. Seanca filloi në ora 12:00 dhe u mbajt nëpërmjet lidhjes video-konferencë.

RENDI I DITËS

1. Arsyetim nga ShTR Protel ShPKNJ P Probishtip, në lidhje me procedurën për fshirjen nga regjistri i radiodifuzerëve.

2. Të ndryshme.

Kryetari i Këshillit, mr. Sasho Stefanovski, konstatoi se në seancë nuk kishte të pranishëm përfaqësues të Shoqërisë Tregtare Radiodifuzive Protel ShPKNJ P Probishtip, nëpërmjet lidhjes video-konferencë. Duke marrë parasysh se, në pajtim me ligjin, seanca është destinuar për arsyetim nga ana e medias në lidhje me procedurën për fshirjen nga regjistri i radiodifuzerëve, dhe për shkak të mungesës së përfaqësuesit të tij, kryetari e deklaroi seancën e mbyllur.

Agjencia e Shërbimeve Mediatike
Audio dhe Audiovizuale
Kryetari i Këshillit,
mr. Sasho Stefanovski